



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5404/prot.
1

Himarë, më 24.07. 2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Himarë.

Të nderuar këshilltarë,

Ju njoftojmë se ditën e enjte më datë 30.07.2026, ora 10:30 në sallën “Neço Muko” Himarë do të zhvillohet mbledhja për muajin korrik, e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, të nenit 53, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Mbledhja do të ketë këtë rend dite.

Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. “Mbi trajtimin e rekomandimeve të Ministrisë së Financave (Drejtoria e përgjishme e buxhetit, drejtoria e financave vendore) për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029, faza I”;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. “Për zbatimin edhe reflektimin në buxhet të ndryshimit sipas VKM-së nr. 536, datë 09.07.2026 “Për propozimin e miratimit të shtimit të fondeve buxhetore për financimin e funksionit, “Mbrotje nga zjarri dhe shpëtimi” dhe një ndryshimi buxhetor mbi buxhetin e vitit 2026, në VKB nr. 32, datë 30.06.2026 “Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026”;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmejet Bashkisë Himarë dhe programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) për zbatimin e projektit “Olive Heritage Himara” të propozuara nga fondacioni “Rruga me pisha”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. “Për dhënien në përdorim për një afat 3-vjeçar nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1 Ha, në ekonominë pyjore Gjomollë me numër pasurie 485, ngastra nr. 9, Z.K 2311, në favor të shoqërisë “Xhulio SH.P.K”;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. “Për miratimin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Himarë dhe shoqërive “Brema ambiente Sh.p.k dhe Gant Costrucion Sh.p.k”, për transportin, pranimin, depozitimin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve të gjenerohen në vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Himarë;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. “Për miratimin e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30 qershor 2026, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike”;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. “Për vijimin e procedurave për shpronësim për interes publik në kuadër të projektit “Ndërtim & rikualifikim i rrugës paralele me rrugën e plazhit Borsh.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit. ;Për miratimin e listës së rrugëve egzistuese sipas horografive.
9. Të ndryshme.

Sekretari

Zaho Dedi

